

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
 QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA
 ZYRA E KRYEMINISTRIT - URED PREMIJERA - OFFICE OF THE PRIME MINISTER
 SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARCHIVE - ARCHIVE SECTOR

Mesa Org. / Org. Unit: 01.6
 Nr. Prot. / Prot. No.: 2661
 Nr. i faqeve / Nr. strana / No. pages: -2-
 Data: 24.08.2016
 Prishtinë / a



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit / Ured Premijera / Office of the Prime Minister

Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur / Vladina Komisija za Nestala Lica / Governmental Commission on Missing Persons

REFERENCË:	- KQPZH - 160/2016
PËR/ZA/TO:	- Përfaqësuesit e Shoqatave Familjare të Personave të Zhdukur ; - Anëtarët e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur ; - Përfaqësuesit e institucioneve / organizatave vendore dhe ndërkombëtare të angazhuara në procesin e ndriçimit të fatit të personave të zhdukur ;
CC:	- z. Ibrahim MAKOLLI, Kryetar i Delegacionit të Kosovës-Grupi Punues për Persona të Zhdukur ; - znj. Lirije KAJTAZI, Kryetare e Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione; - z. Fitim KRASNIQI, Sekretar i Përgjithshëm - Zyra e Kryeministrit ; - z. Edon MYFTARI, Këshilltar Politik i Kryeministrit të Republikës së Kosovës; - Kabinetin e Presidentit të Republikës së Kosovës; - Kabinetin e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës; - Kabinetin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës; - Këshillin Organizativ për shënimin e 30 Gushtit - Dita Ndërkombëtare e Personave të Zhdukur ;
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Prenkë GJETAJ, Kryesues - Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur (KQPZh)
NGA/OD/FROM:	Kushtrim GARA, Udhëheqës i Njesisë së KQPZH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	NJOFTIM: Agjenda për shënimin e 30 Gushtit - Dita Ndërkombëtare për Personat e Zhdukur

Të nderuar,

Në vijim, ju lutemi, gjeni Njoftimin për Agjendën e aktiviteteve me rastin e shënimit të 30 Gushtit - Dita ndërkombëtare për Persona të Zhdukur

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit/Ured Premijera /Office of the Prime Minister

**Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur/ Vladina Komisija za Nestala Lica/ Governmental
Commission on Missing Persons**

Numër: KQPZH- 160/2016
Prishtinë, 24 gusht 2016

NJOFTIM: Agjenda për shënimin e 30 Gushtit - Dita Ndërkombëtare për Personat e Zhdukur

Të nderuar,

Këshilli Organizativ për shënimin e 30 Gushtit - Ditës Ndërkombëtare të Personave të Zhdukur, i përbërë nga përfaqësues të Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur dhe Këshillit Koordinues të Asociacioneve Familjare të të Zhdukurve të Kosovës, kanë përgatitur agjendën e aktiviteteve për shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Personave të Zhdukur, me qëllim të sensibilizimit, ndërgjegjësimit dhe informimit të drejtë të opinionit vendor dhe ndërkombëtar, mbi procesin e ndriçimit të fatit të personave të zhdukur, gjatë luftës në Kosovë.

Aktivitetet e planifikuara për shënimin e 30 Gushtit-Ditës Ndërkombëtare të Personave të Zhdukur, sipas agjendës së finalizuar në takimin e Këshillit Organizativ, mbajtur të Hënën, dt. 22.08.2016, janë të përshkruara në vijim:

- 29.08.2016, ora 11:55, organizimi i Tryezës me temën: 'Dita Ndërkombëtare për Persona të Zhdukur - rasti i Kosovës' (Tryeza do të mbahet në Kuvendin e Republikës së Kosovës)
- 30.08.2016 , ora 09:30, vendosja e luleve te 'Përmendorja dedikuar personave të zhdukur' (përballë Kuvendit të Republikës së Kosovës)
- 30.08.2016, ora 11:00, Tubimi Qendror, në Merdar, Komuna e Podujevës

Të nderuar, në emër të Këshillit Organizativ për shënimin e 30 Gushtit - Dita Ndërkombëtare për Personat e Zhdukur, kemi nderin t'ju ftojme për pjesëmarrje në aktivitetet e lartshënuara

Për çdo informatë shtesë, mund të kontaktoni Njësinë e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur (email: njesia.kqpzh@rks-gov.net , apo përmes telefonit: 0800 08 401)

Të nderuar, ju lutemi falënderimet tona më të sinqerta për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj !

Me respekt,